


01-1831



Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 5 pika 1.2 dhe 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës 05-350/05-75426/21 dt. 27.04.2021 të kërkesit Ministria e Punëve të Brendshme / Policia e Kosovës / Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës në Prishtinë, rr. Luan Haradinaj, pn, Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor-projektin kryesor për, për ndërtimin e aneksit dhe rindërtimin e katit të nën kulmit, në ndërtesën ekzistuese policore, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me dt. 12.12.2022, merr këtë:

## V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I Caktohen kushtet ndërtimore**, kërkesit Ministria e Punëve të Brendshme / Policia e Kosovës / Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, në Prishtinë, sipas kërkesës 05-350/05-75426/21 dt. 27.04.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e ndërtesës së mbajtjes/aneksit me etazhitet P+3 dhe rindërtimin e kulmit dhe atë nga nën kulmi në etazhë të plotë, konkretisht, nga etazhite P+2+Nk në etazhite P+3, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, në kuadër të parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale nr. 6199-0, 6200-0 dhe 6202-0, ZK Prishtinë.

**II. Lokacioni** i shtrirjes së parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, është në zonën e planifikuar me destinim "Ndërtim i lartë";

**III. Gjendja ekzistuese e lokacionit** - parcela kadastrale nr. 6200-2-0 ZK Prishtinë, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe planeve urbane, është:

- Sipërfaqet & pronarët e parcelave kadastrale, janë:
  - nr. 6200-0, me S=54 m<sup>2</sup>, me pronar Komuna e Prishtinës;
  - nr. 6202-0 me S=5912 m<sup>2</sup>, me pronar Komuna e Prishtinës;
  - nr. 6199-0 me S=624 m<sup>2</sup>, me pronar Komuna e Prishtinës;
- E drejta pronësore-juridike është në pronësi të Komunës së Prishtinës, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njëjësive kadastrale nr.;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 6200-2, ZK Prishtinë, janë të ndërtuara katër ndërtesa –me destinim Administrate dhe shëndetësi;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 6199-0, ZK Prishtinë, është e ndërtuar ndërtesa –me destinim Stacion Policor;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni është relativisht i rrafshët;
- Qasja në kompleks – parcelën ndërtimore është nga rrugën e ekzistuese, përkatësisht në rrugën Luan Haradinaj;

**IV. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin-ndërtimin e aneksit dhe duke planifikuar rindërtimin/mbindërtimin e pjesës së ndërtesës ekzistuese, bazuar në parametrat dhe kriteret urbane të Planit Zhvillimor Urban, janë:

- Parcela ndërtimore, organizimi, gabariti, pozicionimi dhe etazhiteti i ndërtesës, qasja në kompleks si dhe raporti i ndërtesës me vijën rregulluese dhe ndërtimore, distanca nga kufiri i parcelës ndërtimore, rrugët dhe vend parkimet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të planifikohen sipas kriterëve të PZHK-se dhe kriterëve të përcaktuara në pikat e këtij paragrafi, duke u bazuar në Planin e lokacionit - "zgjidhja urbane", si dhe "Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga plani rregullues në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01", bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Pjesa e parcelës kadastrale nr. 2805-9 ZK Prishtinë, ku është propozuar të ndërtohet ndërtesa e planifikuar, shtrihet brenda vijës rregulluese të Planit Zhvillimor Urban;
- Me këto kushte ndërtimore në parcelën ndërtimore në kompleksin e Policisë së Kosovës në Prishtinë planifikohet të ndërtohet aneksi –Ndertese e mbajtjes me etazhitet P+3, dhe rindërtimi/ mbindërtimi, përkatësisht shtimi i një kati në pjesën e ndërtesës ekzistuese të Stacionit Policor, nr. 1 në Prishtinë, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projektpropozimit, si në vijim:
  - Ndërtesa e mbajtjes/ Aneksi,  $S=685.44 \text{ m}^2$  e tëra sipërfaqe mbi toke, Etazhiteti: P+3 dhe
  - Rindërtimi/mbindërtimi  $S=761.15 \text{ m}^2$  i me sipërfaqe ekzistuese në shfrytëzim- administrate;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHP), konkretisht shfrytëzimi i parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazën-gabaritin e përdhësës ose suteranit, i përcaktuar sipas PZHU-se, është max. 40%, dhe kjo sipërfaqe, sipas projektpropozimit, është  $S=685.44 \text{ m}^2$ ;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHN), konkretisht shfrytëzimi i parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazën-gabaritin e bodrumit, është max. 60%, bazuar në planin rregullues dhe në paragrafin II, pika 1. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISGJ), sipas Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, është 0.3 (30 %);
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN), i përcaktuar për parcelën ndërtimore është me destinim, "Ndërtim i lartë", dhe trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën  $\pm 0.00$ , 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - *suteren*, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – *bodrum*, dhe kjo sipërfaqe, sipas projektpropozimit, është  $S=685.44 \text{ m}^2$ ;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë dhe tarifë për leje ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, të jetë administrate, me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, etj. (sipas projektpropozimit);
- Etazhiteti maksimal për parcelën ndërtimore, sipas projektpropozimit, është P+3;
- Bazuar në kriteret e planit, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë 1.0 -1.5 H (ku H, është lartësia e ndërtesës mbi tokë), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje 0.5-0.75H ose min. 7m, ku distanca prej 7.0 m vlenë edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore të banesave, etj);
- Distanca në mes të ndërtesave (shumë banesore apo afariste) të fasadat e kombinuara (njëra ndërtesë fasadë ballore, kurse tjetra ndërtesë fasadë anësore) lejohet që distanca të jetë  $0.6 \times H$ ;
- Ngritja e nivelit të përdhësës nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet të jetë max. 1.2 m;

- Qasjet në kompleks të jenë nga rrugët ekzistuese Luan Haradinaj dhe Fehmi Agani;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vendparkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret, mobiluar urban, etj.;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesës dhe materializimi i saj, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe t'i përshtatet destinimit të ndërtesës së planifikuar, si dhe karakterit dhe kontekstit të zonës;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të Plani Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" dhe me normat dhe standardet tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave.

V. **Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"- Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. Dokumentacioni ndërtimor për **Leja Mjedisore Komunale** – bazuar në nenin 9, pika 1 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 01/2017 për Dhënie e Lejes Mjedisore Komunale, përkatësisht shtojcës së këtij udhëzimi, aktiviteti i propozuar sipas projektit konceptual – kompleksi i ndërtesave bujqësore, i nënshtrohet procedurës për pajisje me Leje Mjedisore Komunale. Dokumentacioni ndërtimor-Elaborati për Leje Mjedisore Komunale, i hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

VII. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për **Masat e mbrojtëse nga zjarri**, hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesc, me kuota relative dhe absolute;

- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);

**VIII. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Plani i gërmimit. Në një fletë të vetme të prezantohet në planimetri dhe të paktën dy prerje anësore (si projektion anësor i planimetrisë) të profilit të gërmimit të paraparë. Të përcaktohet kuota absolute e fundimit (niveli i poshtëm i gërmimit). Me vija të ndërprera të paraqitet pozicionimi i bodrumit si në plan ashtu edhe në prerje ;
- Në prerje domosdoshmërisht në të gjitha nivelet të bëhet ndërlidhja në mes të kotës relative (nivelet e dyshemeve) me kotën absolute (lartësitë mbidetare), qartas të lexohet vija e terrenit ekzistues dhe vija e terrenit të projektuar (mbushje-gërmim). Të përdoret gjuhë grafike e cila shpejt bënë të mundur leximin e diferencës në mes të vise së terrenit ekzistues dhe atij të projektuar. Kjo prerje duhet të bëhet duke ju referuar kotave absolute (lartësive mbidetare) të terrenit ekzistues apo rrugëve të projektuara paraprakisht. Në të duhen precizuar kuota absolute e fundimit (niveli i poshtëm i gërmimit), kuota absolute e përdhësës (+- 0,00), kuota absolute e lartësisë maksimale (fundi të murit të atikes tek kulmet e rrafshëta, kurorës dhe kulmarit tek kulmet e pjerrëta).
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha fasadat të jenë të prezantuara duke përfshirë tërë gjatësinë e parcelës dhe relacionin me rrugën dhe ndërtesat në kufijtë me parcelën e trajtuar. Fasadat duhet të prezantohen saktësisht në raport me topografinë e terrenit në mënyrë që pika e prerjes së ndërtesës me vijën e terrenit të lexohet lehtë, saktë dhe shpejt;
- Në fasada të precizohen llojet e materialeve;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tredimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme.
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;

**IX. Vlefshmëria e kushteve ndërtimore është një (1) vit, duke llogaritur nga dita e lëshimit, kurse procedura e ndryshimit dhe plotësimit të tyre të bëhet me kërkesë të pronarëve ose investitorit, në procedurën e njëjtë e të paraparë për lëshimin e tyre.**

### **A r s y e t i m**

Kërkuesi, Ministria e Punëve të Brendshme / Policia e Kosovës / Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, ne Prishtinë, sipas kërkesës të parashtruar 05 Nr. 350/05-75426/21 dt. 27.04.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës afariste – Servisi/Punetoria për makina, me etazhitet P+0, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, është prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- provën mbi të drejtën pronëso-ro-juridike në lokacionin në fjalë ne pronësi te Komunës se Prishtinës, parcela kadastrale nr. 6043-0, 6196-6, 6196-5, 6196-4, 6196-3, 6196-2, 6196-1, 6197-1, 6197-2 dhe 6197-3, ZK Prishtinë;
- Kontrollimi dhe dorëzimi ne përdorim te ndërtesave policore MUP te Misioni i UN \_UNMIK 12A nr. 931/2002 dt. 28.10.2002;
- projektin ideor të objektit te gjendjes faktike si dhe projekt propozimin për ndërtimin e aneksit dhe kthimin e nën kulmit ne etazhe te plotë.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe rregullativës ligjore në fuqi, nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative dhe faktet e vendosjes, në mënyrë kronologjike, ka konstatuar:

Ne procedure te shqyrtimit te lendes, me shkresën plotësim dokumentacioni nr. 05-350/05-75426/21 dt. 06.06.2022, kjo drejtori, ka kërkuar qe lënda te plotësohet me dokumentacionin si ne vijim: Projekti ideor i gjendjes ekzistuese dhe projekti i propozuar (me kriteret e projektimit) dhe kërkesat tjera shtese; Situacioni/planvendosje mbi ortofoto; Në planvendosje të përcaktohet lloji i vegjetacionit të përdorur (lloji i drunjtëve, shkurreve, luleve,...); Në planvendosje të diferencohen (men ngjyra) parkingjet në shërbim të policisë se Kosoves; Në mënyrë diagramatike të paraqitet qasja konceptuale e cila shpjegon parimet bazike të vendosjes së volumit në hapësirën relacionit me tokën, trotualet, rrugët, gjelbërimin, djellëzimin, ajrosjen...; Përcaktimi i kotës +/- 0.00 (hyrjes në përdhese) në ndërlidhje me kotën absolute (ndërlidhja e kotës +/- 0.00 me lartësinë mbidetare; Planimetritë e përbëra nga disa ndërtesa të jenë të paraqitura të gjitha bashkë brenda kufijve të parcelës (jo të ndara veç e veç). Në nivelin e përdheses së përdheses të lexohet qartë dhe saktë relacioni i planimetrisë me rregullimin e parterit Prerje (të paktën dy) në tërë gjatësinë e parcelën ndërtimore ku lexohen saktë pika e prerjes së ndërtesës me terrenin ekzistues (pikë prerja e ndërtesës me terrenin ekzistues); Të gjitha fasadat të jenë të prezantuara duke përfshirë tërë gjatësinë e parcelës dhe relacionin me rrugën dhe ndërtesat në kufijtë me parcelën e trajtuar. Fasadat duhet të prezantohen saktësisht në raport me topografinë e terrenit në mënyrë që pika e prerjes së ndërtesës me vijën e terrenit të lexohet lehtë, saktë dhe shpejt; Vendosje të 3d modelit (qoftë edhe vetëm volumetrik) në relacion ekzistues duke përdorur 3d Google Earth. Relacioni i volumit të propozuar me volumet që e rrethojnë, rrugën, trotualet, vegjetacionin,...); Fotomontazh i ndërtesës së propozuar brenda fotografive të bëra në teren në kohën e aplikimit. Kerkuesi me shkresen Plotesim lende nr. 05-035/05-75426/21/1 dt. 05.11.2021, ka plotesuar kerkesat e kesaj drejtorie.

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të planeve urbane për hapësirën ku gjendet lokacioni, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, si dhe projekt propozimit - projektit ideor për ndërtimin e aneksit dhe zëvendësimin e nën kulmit me etazhe te plote, ka konstatuar se është shqyrtuar kërkesa në tërësi me tërë dokumentacionin e bashkangjitur, dhe pas analizës preliminare të saj dhe konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për ndërtim Nr.04/L -110 dhe konsultimit edhe me Udhëzimin Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, me datë 30.11.2021 ka vendosur shkresën "Njoftim

publik” me projekt propozimin e prezantuar, për njoftimin e publikut dhe lejimin e mundësisë për dhënie e komenteve të pronarëve dhe poseduesve të pronave të rrethinës në diametrin prej 50m’ nga parcela ku synohet të ndërtohet ndërtesa në fjalë. Ky njoftim ka qëndruar në vend deri me datë 14.12.2020 (15 ditë), gjatë së cilës periudhë nuk kanë arritur komente apo ankesa në E-mail adresën e vendosura në njoftimin publik, dhe me këtë procedurë është realizuar kërkesa ligjore e caktimit të kushteve ndërtimore, gjegjësisht vazhdimi i trajtimit të kërkesës për kushtet e propozuara dhe harmonizimit të tyre me kriteret e planit rregullues.

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit-“zgjdhja urbane”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Dispozita urbanistike -“zgjdhja urbane” e kompleksit me ndërtesa të planifikuara

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këto kushte ndërtimore, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

**Ky Vendim u përpilua në katër (4) kopje identike dhe i dërgohet:** Kërkuessit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës.


**Kopja elektronike e këtij Vendimi i dërgohet:** Drejtorisë për Kadastër dhe Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm,

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR.350/02-75426/21 DT. 12.12.2022**

Punoi,  
Lindita Beqiri




U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi



**DREJTORI,**  
Arber Sadiki





studio <b>hapsira</b> shpk Projekthe, Mbikqerim, Konsulenca Adresa: B. Mat. i Prishtinës Tel: +383 045/55123, 045/556 914 Email: info@hapsira.com.mkd	Titulli i projektit:	Investitor:	
	Objekti:	Ndërtimi i Aneksit me destinim si qendër e mbaljes për stacionin Policor-Prishtinë	
	Skica:	STACIONI POLICOR QENDRA E MBAJTJES	
	Projektohet:	Situacioni i Objekteve Besart Halimi bach. Gjeodei. Benjamin Kabashi M.Sc Arch. Edon Berisha bach. Arch.	
faza e projektit: <b>ARKITEKTURA</b> Data: Tetor ,2021 Nr. i protokollit:	Lokacioni: nënshkrimi: nënshkrimi: nënshkrimi:	1:500 A3 A-01	